



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 139-Qershor 2015 - ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>



PAMJE GJATË SHËNIMIT TË 16 QERSHORIT,
DITËS SË DËSHMORËVE DHE DITËS SË ÇLIRIMIT
TË KOMUNËS SË MALISHEVËS

Përmbajtja:

Begaj: Të gjitha drejtoritë do të jenë të angazhuara për shënimin e 16 Qershorit	3
Shënohet 1 Qershori- Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve	4
Begaj: Dëshmorët dhanë jetën për atdhe	5
Nxënësit Bellanicës, kampion në garat e volejbollit në nivel të vendit	5
Begaj: Me investime në serra, synojmë që ta mbulojmë tregun me perime vendore	6
Begaj priti drejtorin e televizionit ndërkombëtar për fëmijë “WADADA”	7
Këshilli Organizativ për shënimin e 16 Qershorit, mbajti takimin e radhës	8
Rishikimi i buxhetit në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës.....	8
Shkolla e Damanekut, pritet të përfundoj në korrik.....	9
Christopher Hill, shpallet “Qytetar nderi” i Malishevës.....	10
Këshilli Organizativ për shënimin e 16 Qershorit, mbajti takimin e radhës	11
Në kuadër të shënimit të 16 Qershorit, u përruan disa projekte në Malishevë.....	12
U shënuar dita e shkollës “Imer Krasniqi”	13
Në Malishevë po qëndron një delegacion nga Orhangazi i Turqisë	14
Delegacioni nga Orhangazi, u prit nga kryetari Begaj dhe qeveria komunale.....	15
Malisheva po shënon Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve.....	16
Kryetari dhe komisioni i aksionarëve takohen me përfaqësuesit e AKP-së.....	23
Brenda dy viteve, pritet të hapet një fabrikë për përpunimin e gomave	23
Në Panorc, u mbajt debat për ndikimin në ambient të ujëmbledhësit	24
U mbajt punëtori për planifikim buxhetor në Malishevë	25
Fillojnë përgatitjet për fushatën e korrje shirjeve	26
KKSB: Malisheva e qetë dhe stabile	28
Qeveria komunale, majtin mbledhjen e rregullt të së hënës	29
Kryetari Begaj, ndau mirënjohje për mërgimtarin Nuhi Mazreku	29

Begaj: Të gjitha drejtoritë do të jenë të angazhuara për shënimin e 16 Qershorit

Malishevë, 1 qershor

Si çdo të hënë edhe sot, Këshilli i drejtorëve ka mbajtur mbledhjen e rregullt, i drejtuar nga Kryetari i Komunës së Malishevës z.Ragip Begaj, ku gjatë kësaj mbledhje, kanë raportuar të gjithë drejtorët e drejtorive komunale për aktivitetet e javës së kaluar dhe javës në vazhdim, e ku veçohen përgatitjet për shënimin e 16 Qershorit, EHKK dhe qarkorja e parë buxhetore për vitin 2016.

Fillimisht gjatë kësaj mbledhje Kryetari i Komunës së Malishevës z.Ragip Begaj ka kërkuar nga drejtorët e të gjitha drejtorive, që të jenë të angazhuar maksimalisht në përgatitjet e shënimin të 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.

Më pas drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport znj.Blerta Krasniqi, njoftoi rreth agjendës e cila është përgatitur nga Këshilli Organizativ për 16 Qershorin, ku parashihen një varg aktivitetesh, kulturore, sportive, pastaj më 16 Qershor, mbledhja solemne e KK-së, manifestimi qendror dhe aktivitetet tjera. Po ashtu, drejtoresha Krasniqi, njoftoi edhe për aktivitetet që sot do të shënohen me rastin e shënimit të 1 Qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve.

Drejtori për Bujqësi z.Hajrullah Mazreku, bëri të ditur, se sot përfundon faza e dytë e repelimit të kafshëve, në kuadër të luftimit dhe parandalimit të EHKK, dhe sipas tij, e tërër faza e repelimit ka shkuar mirë dha p probleme.

Sa i përket situatës endemike me ethet hemorragjike krime kongo (EHKK), drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, tha se “ kemi një numër më të madh të të pickuarve, pasi ngritja e temperaturave, e shton edhe numrin e thumbimeve, mirëpo krahasuar çdoherë me vitin e kaluar qëndrojmë më mirë, dhe situata epidemiologjike është shumë e qetë, pasi nuk kemi asnjë rast të infektuar me EHKK”. Edhe drejtori për mbrojtje dhe shpëtim z.Ahmet Morina tha se “ Sot përfundon faza e parë e dezinfektimit selektiv të zonave endemike, në nëntë fshatra”.

Nga ana tjetër, drejtori i shërbimeve publike, z.Milazim Morina, bëri të ditur, se gjatë javës, pothuajse ka përfunduar i tërër projekti për ndriçimin e qytetit dhe tanimë, ndriçimi është funksional dhe në shërbim të qytetarëve.

Shënohet 1 Qershori- Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve

Malishevë, 1 qershor



Organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në bashkëpunim me OJQ Qendra për Avokim dhe Diplomaci, dhe Ambitions and Values for Progress, Global Youth for Balkans, sot në Malishevë, është shënuar Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve. Me këtë rast, edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i ka përshëndetur qindra fëmijë, të cilët ishin mbledhur në parkun e qytetit, me rastin e

shënimit të 1 Qershorit.

“Unë ndihme mirë, pasi ju sot ndiheni mirë, duke shënuar këtë ditë, jeni të lirë të festoni dhe ta gëzoni ditën e cila ju kushtohet vetëm juve dhe të drejtave tuaja. Dëshiroj që ju dhe të gjithë fëmijët e botës të jeni të gëzuar dhe të lumtur. Ju jeni e ardhmja e ndritur e vendit tonë”, ju tha mes tjerash kryetari Begaj, duke i përshëndetur fëmijët.

Gjatë ditës së sotme, në kuadër të këtij organizimi, janë paraparë disa aktivitete për fëmijët, të shoqëruara me program për fëmijë, këngë, valle dhe lojëra të ndryshme.

KPF mbajti mbledhjen e gjashtë të radhës

Malishevë, 2 qershor

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), i kryesuar nga kryesuesi i KK, z.Aziz Thaçi, ka mbajtur sot mbledhjen e gjashtë të radhës, ku kanë shqyrtuar një varg çështjesh dhe ka dhënë dy rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës.



Para anëtarëve të KPF-së, drejtori për Ekonomi dhe Financa z.Vesel Krasniqi, ka paraqitur ndryshimet e këtyre dy pikave të rendit të ditës, fillimisht rreth shqyrtimit dhe miratimit të Rishikimit të buxhetit për 2015,

dhe më pas edhe rreth shqyrtimit dhe miratimit të kornizës afatmesme buxhetore komunale 2016-2018, ku të dy pikat janë rekomanduar për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit Komunal.

Begaj: Dëshmorët dhanë jetën për atdhe

Malishevë, 2 qershor



Shkollat Filllore dhe të Mesme të Ulëta, “Ibrahim Mazareku” në Malishevë dhe “Visar Krasniqi” në Drenoc, shënuan ditët e shkollave të tyre, në përvjetorët e rënies së dëshmorëve, emrat të cilëve, i mbajnë këto dy shkolla. Me këtë rast, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, tha se “Dëshmorët ranë për ideal, ata dhanë jetën për atdhe”.

“Sot është ditë e veçantë për Malishevën, pasi në këtë datë kanë rënë shumë dëshmorë dhe rënia e dëshmorëve nuk ka qenë e rastësishme, por ata ranë për një qëllim, ata ranë idealin kombëtar, ata ranë për atdhe”, tha mes tjerash në fjalët e tij, kryetari Begaj, të mbajtura në Malishevë dhe Drenoc.

“Me fjalë nuk mund të përshkruhet vepra e dëshmorëve, por ne të gjallët duhet realizojmë mesazhin e dëshmorëve, ne duhet të punojmë për vendin tonë, duhet të punojmë në zhvillimin e vendit, pasi për këtë edhe u sakrifikuam dëshmorët”, tha kryetari Begaj.

Nxënësit Bellanicës, kampion në garat e volejbollit në nivel të vendit

Malishevë, 3 qershor



Nxënësit e SHFMU “Ismail Qemali” nga Bellanica, të shoqëruar nga Drejtori i shkollës z.Isuf Sertolli dhe mësuesen e lëndës Edukatës Fizike, znj.Suzana Sertolli, janë pritur sot nga nënkryetari i Komunës së Malishevës z.Rexhep Mazreku, me rastin e shpalljes Kampion të Kosovës në garat Republikane të Volejbollit, në nivel të shkollave, për këtë vit shkollor.

Me këtë rast, nënkryetari Mazreku, i ka uruar nxënësit, me rastin e suksesit në garat e volejbollit, në nivel republikan. “Unë fillimisht dua ti falënderoj drejtorin e shkollës dhe mësuesen tuaj për angazhimin dhe edukimin, përkatësisht për ngritjen e juaj në aspektin edukativ dhe sportiv. Me këto rezultate ju e nderoni veten tuaj, e nderon shkollën dhe e nderoni Malishevën dhe ne krenohemi me rezultatet e juaja”, tha nënkryetari Mazreku.

Nxënësit e Bellanicës i ka uruar edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj.

Ndërsa drejtoi i SHFMU "Ismail Qemali", z.Isuf Sertolli i falënderoi nënkryetarin Mazreku për pritjen, si dhe drejtorin për arsim, z.Blerim Thaçi dhe drejtoreshën për Kulturë Rini dhe Sport, znj.Blerta Krasniqi, për mbështetjen e vazhdueshme gjatë zhvillimit të garave.

Begaj: Me investime në serra, synojmë që ta mbulojmë tregun me perime vendore

Malishevë, 3 qershor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i shoqëruar nga drejtori për bujqësi, z.Hajrullah Mazreku, sot kanë vizituar disa nga fermerët, përfitues të serrave, donacione të Komunës së Malishevës. Me këtë rast kryetari Begaj, i ka uruar fermerët malishevas, për angazhimin e tyre në bujqësi, përkatësisht në kultivimin e perimeve, duke premtuar vazhdimin e mbështetjes së komunës për bujqit.

“Me angazhimin tuaj ju e ndihmoni, jo vetëm veten tuaj, por e ndihmoni vendin. Pse të mos kemi në tregun tonë perime të kultivuara këtu? Pse të importojmë nga vendet tjera, domate, speca, tranguj e perime tjera, kur i kemi të gjitha mundësit që këto ti rrisim këtu? Këto janë pyetje që duan përgjigje nga institucionet, të cilat duhet ti hartojnë politikat zhvillimore. Për këtë qëllim, ne si komunë, edhe pse me buxhet të kufizuar, do ti përkrahim bujqit vendor”, tha kryetari Begaj, gjatë vizitave të tij në Mleqan, Panorc dhe Llapqevë, ku i ka vizituar disa fermer të suksesshëm, të cilët kanë përfituar nga donacionet e komunës, për ngritjen e serrave. “Synim i imi është që deri në fund të mandatit tim, të arrij ti përkrahi bujqit, përkatësisht kultivuesit e perimeve, në mënyrë që ne të arrijmë ta mbulojmë tregun në Malishevë, me perime të cilat kultivohen brenda Komunës së Malishevës”, tha kryetari Begaj.



Drejtori për bujqësi, z. Mazreku, tha se “drejtoria që drejton, është e angazhuar maksimalisht, që ti përkrahë fermerët dhe për këtë, kemi edhe përkrahjen e kryetarit Begaj, pasi bujqësia, është dega kryesore e zhvillimit ekonomik”.

Ndërsa fermerët të cilët janë përfitues të donacionit për ndërtimin e serrave, e kanë falënderuar kryetarin Begaj dhe Komunën, për përkrahje në ndërtimin e serrave dhe rrjedhimisht edhe zbutjen e papunësisë, pasi serrat e mëdha, kërkojnë edhe krah pune.

Drejtori Mazreku, ka bërë të ditur, se Komuna e Malishevës, ka përkrahur fermerët, në ndërtimin e pesëmbëdhjetë serrave, me bashkëfinancim, ku shtatëdhjetë për qind t shumës, e ka mbuluar komuna, ndërsa tridhjetë për qind, fermerët. I gjithë investimi kap një shumë prej afro 36 mijë euro.

Begaj priti drejtorin e televizionit ndërkombëtar për fëmijë “WADADA”

Malishevë, 4 qershor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim, drejtorin e televizionit ndërkombëtar për fëmijë “WADADA”, holandezin Jan-Willem Bult, përderisa ky i fundit, sot po qëndron në Malishevë, në kuadër të një punëtorie, që ka të bëjë me rrjetëzimin e informacionit për fëmijët, e cila po mbahet sot në Malishevë.

Kryetari Begaj, e falënderoi producentin dhe drejtorin e televizionit WADADA, nga Holanda, për këtë aktivitet në Malishevë. “Ne e konsiderojmë edhe vazhdim i bashkëpunimit me Holandën, ndërsa këtë aktivitet, e konsideroj një ecje me rrjedhat e kohës edhe për fëmijët malishevas, që pavarësisht se jetojmë në vendim më të izoluar të Evropës, megjithatë, edhe ne jemi pjesë e saj dhe me rrjedhat e zhvillimit të përgjithshëm, përfshi, edhe këtë formë që praktikohet, përmes televizionit tuaj”, tha Begaj.

Nga ana tjetër, producenti Bult, tregoi se me këtë formë të rrjetëzimit të informacioneve dhe lajmeve për fëmijët, punohet në shumë shtete të ndryshme të botës, ku fëmijët nga e gjithë bota, shprehen për botën e tyre, për dëshirat dhe për atë se si e shohin botën.

Në këtë punëtori, përveç informimit që do t’ju bëhet fëmijëve, do të shfaqen edhe filma të metrazhit të shkurtër, të realizuar me fëmijë, nga vende të ndryshme të botës me personazhe të ndryshëm, përfshi edhe fytyrat publike, si në sport, me C.Ronaldo, Kaka dhe futbollisten braziliane Marta.

Kjo është hera e parë, që në Kosovë, zhvillohen aktivitete të tilla, për rrjetëzimin e informacioneve për fëmijë, ku përmes Malishevës, edhe Kosova, pritet të jetë pjesë e këtij rrjetëzimi ndërkombëtar.

Këshilli Organizativ për shënimin e 16 Qershorit, mbajti takimin e radhës

Malishevë, 5 qershor

Në kuadër të përgatitjeve për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, Këshilli Organizativ, i formuar për përgatitjen e këtij shënimi, i drejtuar nga Kryetari i Komunës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur takimin e radhës, ku përfundimisht janë dhënë propozimet për çmimet tradicionale, si dhe janë njoftuar me agjendën për shënimin e 16 Qershorit.

Sipas statutit të Komunës së Malishevës, me rastin e 16 Qershorit, ndahen tri çmime, për trimëri dhe heroizëm, për kontribut në arsim dhe për kontribut në shëndetësi, ndërsa Këshilli Organizativ, i ka shqyrtuar të gjitha propozimet dhe i ka dërguar për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës, propozimet për këto çmime.

Në mbledhjen e sotme, Këshilli Organizativ, u njoftua edhe me agjendën për shënimin e 16 Qershorit, ku parashihen një varg aktivitete, si mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës, pastaj, homazhet dhe nderimet në varrezat e dëshmorëve, manifestimi qendror, zbulimi i pllakës me emrat e të vrarëve gjatë luftës, aktivitete këto që do të përmbillen me koncertin e mbrëmjes.

Sipas drejtoreshës për Kulturë, Rini dhe Sport, znj.Blerta Krasniqi, “këtyre aktiviteteve, do t’ju paraprinë një varg aktivitete tjera, sportive, kulturore, shfaqje teatrale, ekspozita dhe të tjera, ku do t prezantohen vlerat më të mira të Komunës së Malishevës, ndërsa nuk do të mungojnë as mysafir nga vendi dhe jashtë vendit, të cilët tashmë e kanë konfirmuar prezencën e tyre në këto aktivitete”.

Rishikimi i buxhetit në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës

Malishevë, 8 qershor

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur takimin e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, ku drejtuesit e drejtorive, kanë paraqitur punët dhe angazhimet e drejtorive gjatë javës së kaluar dhe planifikimin për javën në vijim, ku në mesin e temave, ishin përgatitjet për shënimin e 16 Qershorit dhe rishikimi i buxhetit për vitin 2015.

Fillimisht, drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, znj.Blerta Krasniqi, tha se të gjitha përgatitjet janë bërë dhe aktivitetet në kuadër të shënimit të 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Malishevës, tashmë kanë filluar, kryesisht aktivitetet sportive, ndërsa edhe ato kulturore do të fillojnë këto ditë, ndërsa e tërë java është e ngjeshur me aktivitete të ndryshme.

Ndërsa drejtori i drejtorisë për ekonomi, buxhet dhe financa, z.Vesel Krasniqi, ka bërë të ditur, se “në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, do të bëhet rishikimi i buxhetit për vitin 2015, pasi kjo pikë është futur në rend dite, e po ashtu, edhe qarkorja e parë buxhetore për vitin 2016, do të diskutohet në këtë mbledhje”.

Ndërsa, sipas drejtorit të shëndetësisë, z.Hajdin Berisha, bëri të ditur se situata epidemiologjike është e qetë dhe nuk ka asnjë rast të infektuar me ethe hemorragjike krime kongo, përderisa thumbimet nga rriqrat, vazhdojnë për shkak të motit, por në raport me vitin paraprak, ka më pak raste dhe ky është një sinjal i mirë.

Shkolla e Damanekut, pritet të përfundoj në korrik

Malishevë, 10 qershor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, së bashku me zyrtarin nga zyra e Agjencionit Evropian, z.Diamant Kazazi dhe punë kryesit në ndërtimin e objektit të shkollës në fshatin Damanek, sot kanë inspektuar punimet gjatë ndërtimit të objektit të shkollës, e cila financohet nga Agjencioni Evropian, përmes zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, e ku u tha se deri në gjysmën e

korrikut, objekti pritet të jetë i gatshëm.

Shkolla në Damanek, është prej shkollave më modernet në vend dhe e ndërtuar sipas standardeve evropiane, ndërsa ka një hapësirë prej 1500 metrave katrorë, e përcjellë me dhoma mësimi, salla e sportit si dhe me oborr të rregulluar, e cila financohet nga Bashkimit Evropian dhe ka kushtuar rreth një milion euro.

Kryetari Begaj, me këtë rast, i ka përgëzuar punë kryesit për punën e jashtëzakonshme, për ndërtimin brenda afatit dhe sipas planifikimit. “Ky objekt shkollor është ndër të rrallët që ka në vendin tonë, e ndërtuar me standarde dhe shumë e përshtatshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie”, tha Begaj.

Ndërtimi i shkollës ka filluar në muajin maj të vitit të kaluar dhe pritet të jetë gati në gjysmën e korrikut të këtij viti.

Christopher Hill, shpallet “Qytetar nderi” i Malishevës

Malishevë, 11 qershor



Me kërkesën e Kryetarit të Komunës, z.Ragip Begaj, Kuvendi i Komunës së Malishevës, dje në mbledhjen e rregullt të saj, e ka shpallur ish ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), z.Christopher Hill, “Qytetar nderi” i Malishevës, me motivacionin “Personalitet i shquar i politikës dhe diplomacisë amerikane, që ka dhënë ndihmesë të pa kursyer për krijimin e shtetit të Republikës së Kosovës”. Anëtarët e KK të

Malishevës, unanimisht e kanë votuar këtë kërkesë, duke e cilësuar si një nderë i madh për Malishevën, duke pasur parasysh, kontributin e Hillit, para, gjatë dhe pas luftës, për Kosovën, por edhe lidhjen me Malishevën.

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në këtë mbledhje, ka marrë vendim edhe për ndarjen e çmimeve tradicionale që ndahen me rastin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Malishevës, sipas nenit 9 të statutit të Komunës së Malishevës. Çmimi për Trimëri dhe Heroizëm “Imer Krasniqi”, këtë vit ju nda Isa Hoxhës dhe Skënder Hotit, pjesëtarë të ish UÇK-së, përkatësisht të brigadave 122 dhe 121. Çmimi për kontributin e dhënë shkollën shqipe “Hamdi Berisha”, ju nda Iliaz Zogajt dhe Mihrije Bytyçit. Dhe çmimi për kontributin e dhënë në shëndetësi “Dr.Shpëtim Robaj”, ju nda Selim Krasniqit dhe Afrim Krasniqit.

Përndryshe, në mbledhjen e djeshme të rregullt të KK të Malishevës, të drejtuar nga kryesuesi i KK-së, z.Aziz Thaçi, u shqyrtua edhe raporti i të hyrave dhe shpenzimeve komunale në tremujorin e parë të vitit 2015 (janar-mars 2015), pastaj u miratua edhe rishikimi i buxhetit për vitin 2015 si dhe u miratua korniza afatmesme buxhetore 2016-2018.

Në këtë mbledhje, u miratua në lexim të parë edhe Rregullorja për Transparencë në Komunën e Malishevës, pastaj u miratua edhe raporti njëvjeçar i punës së Komiteti për Komunitete, si dhe u miratua dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronës publike, bazuar në konkursin publik 01/335 për qëllim të investimeve private.

Në mbledhjen e sotme, paraprakisht është bërë edhe zëvendësimi i anëtares së KK të Malishevës, Donjeta Foniqi me Jetmira Vrenezin, nga Lëvizja “Vetëvendosje”, ndërsa mbledhja filloi me një minutë nderim me rastin e rivarrimit të Isa Boletinit.

Begaj priti përfaqësuesit e UN-HABITAT-it dhe organizatës SIDA

Malishevë, 11 qershor



Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, dhe nënkryetari z.Rexhep Mazreku, kanë pritur në një takim përfaqësuesit e UN-HABITAT në Kosovë, të cilët janë duke e zbatuar Programin e Përkrahjes së Planifikimit Hapësinor Komunal që financohet nga qeveria suedeze, si dhe përfaqësues nga Swedish International Development Agency (SIDA) dhe Ambasada Suedeze në Prishtinë, ku është biseduar për zhvillimet e deri tanishme të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), si dhe për hapat e mëtejshëm,

drejt përfundimit të këtij plani, si dhe kanë vizituar urën në rrugën kryesore të qytetit.

Kryetari Begaj, me këtë rast, i ka falënderuar për vizitën dhe për “ndihmën profesionale të dhënë për Malishevën, në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, pasi kjo është një ndër gjërat më të rëndësishme drejt zhvillimit të Komunës së Malishevës”. “Për ne po ashtu edhe zgjerimi i urës së qytetit është një punë shumë e mirë dhe e vlerësoj jashtëzakonisht shumë, ngase jo vetëm që i ka dhënë një imazh të bukur qytetit, por edhe e ka përmirësuar lëvizshmërinë e qytetarëve”, tha Begaj. Më pas i njoftoi edhe për gjendjen e Malishevës gjatë periudhave të ndryshme, pastaj rreth zhvillimeve të deri tashme dhe vështirësitë me të cilat po ballafaqohet ende.

Përfaqësuesit e UNHABITAT-it- në Kosovë, dhe përfaqësuesit e organizatës SIDA, falënderuan Kryetarin Begaj për kohën dhe pritjen, ku dhe u shprehën të kënaqur me realizimin e projektit të urës së qytetit, e po ashtu u shprehën të gatshëm që të vazhdojnë edhe më tutje bashkëpunimin edhe në realizimin e projekteve tjera.

Përfaqësuesit të cilët u pritën nga Kryetari Begaj ishin:

Znj.Gwendoline Mennetrier - Udhëheqëse e Programit të UN-HABITAT në Kosovë.

Z.Ishaku Maitumbi - planer ndërkombëtar, UN-HABITAT në Kosovë.

Z.Stig Egnell, Këshilltar Monitorues, SIDA.

Z.Fatos Mulla - Zyrtar Programesh, Ambasada Suedeze ne Prishtinë.

Këshilli Organizativ për shënimin e 16 Qershorit, mbajti takimin e radhës

Malishevë, 12 qershor

Këshilli Organizativ, për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, i kryesuar nga kryetari i Komunës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur takimin e radhës së këshillit, kësaj radhe së bashku me Këshillin e Drejtorëve, ku është biseduar rreth organizimit të kësaj dite, me rëndësi për Malishevën.

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, njëherit edhe kryesues i këshillit organizativ, tha që “Ne jemi në vigjilje të festës dhe në përfundim të finalizimit të të gjitha aspekteve teknike të organizimit dhe shënimit të 16 Qershorit, dhe në këtë takim të përbashkët duhet të finalizohen të gjitha

aspektet teknike të organizimit, pasi 16 Qershori, është jo vetëm ditë e veçantë, por është dita më e rëndësishme për Komunën e Malishevës”.

Po ashtu Këshilli Organizativ dhe Këshilli i Drejtorëve i kanë harmonizuar të gjitha aktivitetet të cilat të zhvillohen gjatë këtyre ditëve, duke filluar me pritjen e mysafirëve dhe të qytetarëve, zhvillimin e aktiviteteve të cilat janë paraparë të mbahen, e deri te përfundimi i tyre.

Në kuadër të shënimit të 16 Qershorit, u përruan disa projekte në Malishevë

Malishevë, 15 qershor



Në vigjilje të 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, sot janë përruar disa rrugë, një fushë sporti, si dhe ka filluar ndërtimi i një rruge tjetër. Me këtë rast, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i ka uruar qytetarët për këto projekte, të cilat janë në shërbim të qytetarëve, nxënësve dhe të rinjve.

Në shkollën fillore “Visar Krasniqi”, është përruar fusha sportive në ambient të hapur, e cila është njëra prej fushave të sportit që janë ndërtuar këtë vit në shkollat e Komunës së Malishevës, ky kryetari Begaj, i ka uruar nxënësit që krahas mësimit në lëndë tjera, të merren edhe me sport, dhe nesër të tregojnë rezultate të mira edhe në sport.

Po ashtu në Drenoc, janë përruar dy rrugët e ndërtuara më herët dhe pas përfundimit të të gjitha punëve teknike, kryetari Begja, i shoqëruar nga drejtorët komunal, i kanë përruar këto rrugë. Po ashtu një rrugë është përruar edhe Shkarashnik, ku kryetari Begaj, i ka uruar banorët për këtë rrugë, ndërsa ka marrë falënderime nga ana e qytetarëve për të gjitha këto investime. Këto rrugë, janë në kuadër të ndërtimit të rrugëve brenda fshatrave, ku përveç Drenocit Shkarashnikut, janë shtruar rrugë edhe në Marali, Burim, Mleqan, Berishë dhe fshatra tjerë.



Po sot, ka filluar edhe ndërtimi i rrugës 1.7 kilometra në Dragobil, rrugë e cila e lidhë lagjen Pallanka me fshatin, pasi deri më tani, kjo lagje duhej të përshkonte një rrugë të gjatë, për tu

lidhur me fshatin. Edhe këtu kryetari Begaj, i ka uruar banorët e fshatit për këtë rrugë e cila krijon shumë lehtësi në qarkullimin dhe komunikimin në mes lagjeve të fshatit.

U shënua dita e shkollës “Imer Krasniqi”

Malishevë, 15 qershor




Sot në fshatin Carrallukë, në 16 vjetorin e rënies, u shënua dita e shkollës, e cila mban emrin e dëshmorit të kombit Imer Krasniqi, dëshmorit të parë të Komunës së Malishevës, në luftën e lavdishme të UÇK-së. Në këtë ditë u vlerësua lartë figura dhe vepra e Imer Krasniqit, i cili është edhe nismëtar i ndërtimit të shkollës, e cila sot me krenari e mban emrin e tij.

Me këtë rast, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, duke marrë fjalën, pasi e përshëndeti nënën e dëshmorit, tha mes tjerash se “themelet e kësaj shkolle, janë nga Imeri dhe janë nga gjaku i dëshmorëve tanë”. Më pas kryetari Begaj, përveç shkollës, foli edhe për jetën e Imer Karsniqit, ish bashkëluftëtar i tij, dhe në fund përkujtoi disa momente, gjatë luftës, kur Imer Krasniqit i kishte thënë ”të bënte kujdes, ai ja kishte kthyer: S’kam nevojë të bëj kujdes. Unë e kam kryer obligimin tim edhe nëse vritem, pasi kësaj toke i kam dhënë 11 fëmijë”.

Përveç fjalimeve nga drejtorja e shkollës dhe familja, u shfaq edhe një program i pasur kulturor dhe artistik, me këngë, valle e poezi, kushtuar dëshmorit të kombit, Imer Krasniqi dhe dëshmorëve të tjerë.

U mbajtën shumë aktivitete kulturore për 16 Qershor

Malishevë, 15 qershor



Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Malishevës, sot janë zhvilluar disa aktivitete kulturore. Sot është hapur edhe ekspozita e pikturës në kuadër të aktiviteteve kulturore, si dhe janë shpallur fituesit e konkursit artistik, pastaj është dhënë shfaqja artistike për fëmijë “ Gjyshi im kuller“.

Në hapjen e ekspozitës, mori pjesë nënkryetari i Komunës së Malishevës z.Rexhep Mazreku, i cili

uroi artistët që kanë marrë pjesë në këtë ekspozitë nga të gjitha viset e Kosovës dhe ata nga Shqipëria. “Ju falënderoj për kohën e çmuar që keni gjet të vini në festën ton me të madhe në Ditën e Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, pjesëmarrja e të gjithë këtyre artisteve këtu e madhështon festën tonë dhe i jep vlerë e na nderon, ju dëshiroj suksese të gjithë artistëve, ndërsa të gjithë qytetarëve të Malishevës, ju uroj ditën e çlirimit”, tha nënkryetari Mazreku.

Më pas juria e përbërë nga Hana Bytyçi, Agron Kastrati, Agim Kryeziu, bën publike edhe rezultatet e konkursit artistik. Sipas jurisë, në poezi vendi i parë i takoi shifrës “Gradina”, i dyti shifrës “Muza”, dhe vendi i tretë shifrës “Shkaba”. Në këngë, vendi i parë i takoi Adem Kastratit, i dyti Vellezërve Zogaj, dhe i tretë Refki Mazrekut. Në pikturë vendi i parë i takoi Sabedin Etemi, i dyti Pano Kondi dhe vendi i tretë Elenica Paloli.

Në Malishevë po qëndron një delegacion nga Orhangazi i Turqisë

Malishevë, 15 qershor

Sot në Malishevë, ka ardhur për një vizitë tri ditore, një delegacion nga Komuna e Orhangazit në Turqi, të cilët të do të qëndrojnë në Malishevë, në kuadër të shënimit të Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve. Delegacioni turk i përbërë nga tetë persona, udhëhiqet nga kryetari Komunës së Orhangazit, z. Neşet Çağlayan, ndërsa në përbërje të delegacionit janë edhe zyrtar të komunës, nga Asambleja Komonale dhe nga komuniteti i biznesit.



dhe Orhangazit, si dhe për vazhdimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes të përbashkët.

Delegacioni turk, po qëndron në Malishevë, me ftesë të kryetarit të Komunës së Malishevës, z. Ragip Begaj, me qëllim të pjesëmarrjes në shënimin e 16 vjetorit të çlirimit të Malishevës. Kjo vizitë, përveç pjesëmarrjes në këtë shënim, do të shfrytëzohet edhe për vazhdimin e kontakteve mes dy komunave të binjakëzuara, Malishevës

dhe Orhangazit, si dhe për vazhdimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes të përbashkët.

Delegacioni nga Orhangazi, sot është pritur nga kryetari Begaj, dhe do të jenë pjesë e të gjitha aktiviteteve që do të zhvillohen gjatë këtyre ditëve, me rastin e shënimit të ditës më të madhe për Malishevës, 16 Qershorin, Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve.

Delegacioni nga Orhangazi, u prit nga kryetari Begaj dhe qeveria komunale

Malishevë, 15 qershor



Delegacioni turk nga Komuna e Orhangazit, i prirë nga kryetari i kësaj komune, z.Neşet Çağlayan, sot është pritur nga kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe qeveria komunale e Malishevës, me rastin e vizitës së delegacionit nga kjo komunë, që po i bëjnë Malishevës, me rastin e shënimit të 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.

Pasi i falënderoi për pjesëmarrje, kryetari Begaj, tha: Shpresoj që bashkëpunimi me komunën e binjakëzuar të Orhangazit të vazhdoj edhe në aspektin kulturor. Turqia ka dhënë kontribut për Kosovën, para, gjatë dhe pas luftës dhe është prej shteteve të para që e ka njohur Pavarësinë e Kosovës. Fuqitë e mëdha e kanë përkrahur Kosovën, dhe kjo na lë të kuptojmë se edhe ne jemi pjesë e botës demokratike. Vizita juaj na nderon dhe ju jeni në shtëpinë tuaj këtu, andaj edhe ndihuni si në shtëpinë tuaj, gjatë qëndrimit këtu.

Ndërsa, kryetari i Orhangazit, z.Neşet Çağlayan, pasi shprehi falënderimet e tij për mikpritjen e bërë, e uroi kryetarin Begaj dhe qytetarët e Malishevës, me rastin e 16 Qershorit. “Jam i kënaqur që gjendemi në komunën e binjakëzuar dhe këtu sigurisht se ndihemi si në shtëpinë tonë. Këto janë jo vizita, por takime të miqve të afërt. Këto takime janë të rëndësishme për shkëmbimet tona kulturore dhe në fushat tjera. Nëse gëzimi shkëmbehet, ai gëzim shtohet dhe ne këtu kemi ardhur të festojmë së bashku me ju, me rastin e 16 Qershorit”, tha kryetari i Orhangazit z. Neşet Çağlayan.

Ndërsa, ish deputeti i parlamentit turk, nga rrethina e Bursës, z.Ismail Ayden, duke marrë fjalën, tha se “Kosova është vend i veçantë për ne, pasi ne në Bursa jetojmë me shqiptarët, madje kryetari ynë në Bursa, është shqiptar, prandaj edhe sot ndihem shumë mirë këtu. Unë uroj që bashkëpunimi mes dy komunave, të vazhdoj të rritet dhe uroj që zhvillimi i Malishevës dhe i Orhagazit, të jetë i përbashkët”.

Më pas delegacioni nga Orhangazi, ka vizituar Qendrën e Kompetencës dhe disa nga bizneset në Malishevë, duke u njohur me biznese dhe duke shkëmbyer njohje me komunitetin e biznesit në Malishevë.

Malisheva po shënon Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve

Malishevë, 16 qershor



Me aktivitete të shumta, sot në Malishevë, po shënohet 16 Qershori-Dita e Çlirimit dhe Dita e Dëshmorëve të Komunës së Malishevës. Aktivitetet kanë filluar me pritjen e qytetarëve në zyrën e Kryetarit të Komunës, për urime, pastaj kanë vazhduar me seancën solemne të mbajtur nga Kuvendi i Komunës së Malishevës.

Në këtë seancë, fjalë rasti mbajtën kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe kryesuesi i KK të Malishevës, z.Aziz Thaçi, të cilët në mënyrë kronologjike, folën për rëndësinë e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit, por e kjo datë rezulton e me Ditën e Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, pasi, me 16 qershor 1998 ra dëshmori i parë, Imer Krasniqi dhe dëshmori i fundit Mentor Gashi, me 16 qershor të vitit 1999.

“ Dëshmorët e kombit dhanë më të shtrenjtën, për ta fituar më të shtrenjtën . LIRINË. Ne gjithmonë do të ulemi me respekt të veçantë para tyre”, tha mes tjerash kryesuesi i KK të



Malishevës, z.Aziz Thaçi në fjalën e tij, të mbajtur sot para anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Më pas, aktivitetet zyrtare kanë vazhduar me nderime pranë Shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari, në parkun e qytetit, për të vazhduar me homazhe dhe nderime në varrezat e dëshmorëve në Malishevë dhe Kleçkë, ku gjenden varrezat e dëshmorëve të brigadave 122 dhe 121, brigada të cilat vepruan në territorin e Komunës së Malishevës.

Në ora 13 është mbajtur Manifestimi Qendror, ky fjalën kryesore e pati i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj, i cili në fjalimin e tij, i paraqiti zhvillimet në Malishevë, që nga formimi i komunës për herë të parë, pastaj për herë të dytë, luftën e UÇK-së, formimin e komunës për herë të tretë dhe zhvillimin e deritanishëm. Në këtë tubim morën pjesë edhe Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z.Qemajl Minxhozi, deputetë e Kuvendit të Kosovës, Fatmir Limaj, njëherit edhe kryetar i “Nisma për Kosovën”, pastaj deputeti Enver Hoti dhe Haxhi Shala, delegacioni nga Turqia, shoqatat e dala nga lufta, “Miqte e Amerikës” dhe shumë personalitete tjera.

Në fjalën e rastit, Ambadori Minxhozi, tha se “ Malisheva e vogël me peshë të madhe ka lënë gjurmë në historinë tonë, në mënyrë të veçantë në luftën e lavdishme të UÇK-së. Për liri duhen vepra, e kërë e bëri më së miri populli shqiptar dhe UÇK, e cila bëri një luftë të madhe që solli drejtësinë në vend”.

Ndërsa, kryetari i “Nisma për Kosovën, z.Fatmir Limaj, në fjalën e rastit, bëri thirrje për punë dhe angazhim nga të gjithë, pasi sipas tij “Malisheva ka pasuri të madhe intelektuale, ndërsa 16 qershori, duhet të jetë një festë për të gjithë të rënë në të gjitha kohët. Ai më pas tha se “liria ka ardhur nga gjaku u derdhur i dëshmorëve dhe këtë ju them atyre që ende kanë dyshime për këtë”. Limaj, foli edhe për luftës, si njëri nga protagonistët kryesor të luftës në këtë pjesë dhe sipas tij, “Malisheva dhe treva e Llapushës, gjithmonë kanë ditur të organizohen në luftëra dhe ta mbrojnë vendin”.

Këtë ngjarje, e ka përshëndetur edhe kryetari i Komunës së Orhangazit, z.Heset Çaglajan, i cili shprehi kënaqësinë e tij që gjendet këtu, në këtë ditë të rëndësishme për Malishevën, duek festuar së bashku me popullin e Malishevës.

Më pas u ndanë edhe çmimet tradicionale. Çmimi për trimër dhe heroizëm “Imer Krasniqi, ju nda Skënder Hotit dhe Isë Hoxhës, çmimi për kontributin e dhënë në arsim “Hamdi Berisha”, ju nda Iliaz Zogajt dhe Mihrije Bytyçit dhe çmimi për kontribut në shëndetësi ju nda Selim Krasniqit dhe Afrim Krasniqit.



Në këtë manifestim, u lexua edhe vendimi për shpalljen “Qytetar Nderi” i Malishevës për Christopher Hill, e me këtë rast, në pamundësi të prezencës së të Hillit, kryetari shoqatës “Miqtë e Amerikës”, z.Agim Rexhepi, lexoi një deklaratë të Christopher Hill, lidhur me dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Malishevës. Në letrën e Hillit, dedikuar ditës së sotme, thuhet: **Është nderë të jem qytetar i një qyteti që pagoi një çmim kaq të shtrenjtë që kosovarët të gëzojnë lirinë tani. Jam shumë i prekur nga gjesti juaj gjentil dhe bujar. Për fat të keq, nuk mundem të marr pjesë fizikisht me 16 qershor, por ju siguroj se do të jem atje me shpirtin tuaj.**

Po ashtu kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka ndarë mirënjohje edhe për mërgimtarin z.Nuhi Mazreku, për kontributin e dhënë shkollën shqipe në Suedi dhe për kontributin e dhënë për Malishevën.

Pas manifestimit qendror, po në parkun e qytetit, është bërë zbulimi pllakës përkujtimore me emrat e të gjithë të vrarëve nga forcat e armikut, gjatë periudhës së luftës 1998-1999. Zbulimi i tri pllakave me emrat e të gjithë të rënëve, e bënë, kryetari i Malishevës, Ragip Begaj dhe kryetari i Orhangazit, z.Heset Çagljan, pllakën e dytë Ambasadori i Republikës së



Shqipërisë, z.Qemajl Minxhozi dhe kryetari i “Nisma për Kosovën”, z.Fatmir Limaj, ndërsa pllakën e tretë, e zbuluan disa nga familjarët e të vrarëve gjatë luftës 1998-1999.

Manifestimet do të vazhdojnë me koncertin e madh që mbahet në qendër të Malishevës, e ku do të marrin pjesë emra të njohur të estradës kosovare, malishevase dhe të mysafirëve të tjerë dhe të gjitha aktivitetet do të përmbyllen me ndezjen e fishekzjarrëve.



Në vazhdim, fjalimi i Kryetarit të Komunës së Malishevës, të mbajtur në manifestimin qendror, të mbajtur me rastin e shënimit të 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës:

Komuna e Malishevës dhe qytetarët e saj, kanë pasur një historik mjaft të dhimbshëm dhe me plot sakrificë, sikurse edhe kombi shqiptar në përgjithësi. Fillimisht, pas luftës së dytë botërore, u formua Komuna e Malishevës, në vitin 1960 dhe kishte në përbërjen e saj 44 vendbanime, por për shkak të rrethanave të kohës, në vitin 1965, u shpërbë dhe u nda në katër komuna dhe rrjedhimisht qytetarët e Komunës së Malishevës, u kthyen në gjendjen e viteve pesëdhjeta.

Qytetarët e Malishevës, gjatë kësaj periudhe me shumë vështirësi përballuan ndarjen, për të pritur vitin 1986, kur banorëve të kësaj treve prapë po ju kthehej jeta e përbashkët në komunën e tyre. Me bashkimin e fshatrave, filloj përmirësimi i jetës së qytetarëve, filloi rregullimi i infrastrukturës në përgjithësi, ndonëse okupimi i vazhdueshëm ishte rrethanë që gjithmonë e rëndonte jetën e qytetarëve të Komunës së Malishevës.

Gjatë viteve të tetëdhjeta, dita ditës rëndohej jeta e qytetarëve nga pushtuesi serbo sllav. Vrasjet, dhuna, burgosjet, presioni i vazhdueshëm i pushtuesit, në vend të dorëzimit, qytetarët e Malishevës i bënte edhe më të fortë. Në vitin 1990, protesta e qytetarëve të Komunës së Malishevës, u shtyp me dhunë, duke u vrarë qytetarët tanë në qendër të Malishevës, e që në opinionin e gjerë njihet si “Masakra e Malishevës”. Kjo ngjarje, bëri që udhëheqja komunale, për herë të parë të ishte në akord me kërkesat e qytetarëve dhe kërkonte, në formë institucionale, që të dënohej krimi i bërë dhe të dënoheshin kriminelët dhe urdhërdhënësit për vrasjet e bëra.

Për shkak të mospërfilljes së pushtuesit, për shkak të zhvillimit të rrethanave politike të asaj kohe, e të cilave ju parapriu popullata e Komunës së Malishevës, përsëri në vitin 1991, vjen deri te suprimimi i Kuvendit të Komunës së Malishevës. Ky fat i keq ishte vetëm për Malishevën e për asnjë komunë tjetër në Kosovë, vetëm e vetëm se Malisheva ishte e pastër etnikisht dhe natyrishtë kryengritëse dhe e padëgjueshme për okupatorin.

Edhe pse pushtuesi i atëhershëm, me vendime të tilla bënte formimin dhe suprimimin e Kuvendit Komunal, kurrë nuk mund të ndalte ndjenjën e ushqyer prej kohësh të qytetarëve të Komunës së Malishevës, për dinjtet, liri dhe çlirim.

Dhuna dhe shtypja ndaj qytetarëve të Komunës sonë, sikur edhe në tërë vendin, bëri që populli shqiptar në Kosovë, të forcohej dhe të organizohej në forma tjera për ta fituar lirinë.

Të nderuar qytetar të Komunës së Malishevës,..... si rezultat i kësaj, lindi Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Me formimin e njësive të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Malisheva, jo vetëm që u bë vendstrehim, por u bë pjesë aktive e organizimit. Me shtimin e numrit të pjesëtarëve të UÇK-së, filluan edhe lëvizjet dhe sulmet kundër forcave të ushtrisë dhe policisë serbe. Pas luftës së lavdishme të Familjes Jashari dhe rënies së Komandanti legjendar të UÇK-së, Adem Jasharit, UÇK-ja në Malishevë, u rrit edhe më shumë, duke u organizuar në njësitet e saja "Lumi" dhe "Çeliku", dhe duke krijuar një territor të lirë, me një hapësirë prej mbi 300 kilometra katror, e mjaftueshme për lëvizjen e lirë të qytetarëve, por territor i mjaftueshëm edhe për rritjen dhe furnizimin e territoreve tjera ku vepronte UÇK-ja.

Në vitin 1998, Malisheva u shpall "Zonë e Lirë", nga Orllati, nga Kijeva, nga Bllaca dhe nga Rahoveci, në tërësi ishte territor i kontrolluar nga UÇK-ja. Kjo e bëri Malishevën të njohur në tërë botën. Këto pozicione, mbroheshin nga djemtë dhe vajzat më të devotshëm të Malishevës dhe viseve tjera, realizmi i ëndrrës së armikut, që të shkelet Malisheva, në këtë kohë ishte e pamundshme. Kjo situatë e krijimit të zonës së lirë, mundësoj vendosjen e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, u mundësua hapja e spitaleve të para ushtarake, u formua edhe drejtoria e parë civile-ushtarake, më vonë u hap edhe radio e parë e "Kosovës së Lirë", u krijua agjencia e parë e lajmeve "Kosovapress". Ushtarët malishevas, me dinjitet mbrojtën këto territore dhe pavarësisht që djemtë më të mirë, vriteshin në vijat e frontit, njerëzit këtu lëviznin të lirë, për muaj të tërë. Kështu me 16 qershor të vitit 1998, ra edhe dëshmori i parë, Imer Krasniqi, emrin e të cilit, më pas, me krenari do ta mbante Brigada 122.

Gjatë kësaj kohe, filloi edhe riorganizimi i UÇK-së, në strukturat e saj, dhe këtu vepruan dy brigada, 121 dhe 122, ku ishin të rreshtuar me mijëra djem dhe vajza të Malishevës dhe vendeve tjera.

Ushtria, paramilitarët, mercenarët dhe policia serbe, morën ofensiva të ashpra kundër UÇK-së, në territorin e Malishevës, por duke mos mundur të shpartallonin UÇK-në, kishin zgjedhur një formë tjetër të hakmarrjes. Ata vrisnin civilët, fëmijë e pleq, gra e burra të pafajshëm, përmes granatimeve. Edhe pse ofensivat ishin të ashpra, të shumta në numër dhe në arsenal të fuqishëm ushtarak, shumë fish më shumë se UÇK-ja, megjithatë, ne arritëm, që përmes betejave, të ashpra, ta mbrojmë popullatën civile të zhvendosur në vendet e caktuara.

Si rezultat i kësaj lufte, si rezultat i krijimit të këtyre institucioneve vendore, në këtë pjesë, u vendosën edhe misionet e ndryshme diplomatike, si Zyra e Misionit Diplomatik Amerikan në Kosovë (KDOM), në Dragobil, që me të drejt konsiderohej edhe si ambasada amerikane në Kosovë, pastaj prezenca e misionit të OSBE, si dhe prezenca edhe e medieve më të fuqishme botërore. Këtu u zhvilluan pothuajse të gjitha takimet mes Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së me misionet ndërkombëtare dhe ambasadorët e dërguar për ndërmjetësim.

Të nderuar të pranishëm, të nderuar qytetarë,

Gjenocidit serb, nuk i shpëtoi as Malisheva. Me fillimin e bombardimeve të NATO-së, forcat serbe e shfrynë mllëfin e tyre mbi popullatën civile, duke vrarë mbi 350 qytetar, mbi 30 të tjerë, të cilët ende janë të zhdukur. Madje, edhe në ditën e fundit të tyre me 16 qershor të vitit 1999, ushtria serbe, tentonte të shkatërronte edhe ato pak ndërtime që kishin mbetur në këmbë. Dhe në mbrojtje të kësaj, ra edhe dëshmori i fundit i Malishevës, Mentor Gashi, me 16 qershor 1999.

Të nderuar qytetarë të Komunës së Malishevës:

Pse kjo është ditë e veçantë për Malishevën:

Rënia e Dëshmorit të parë me 16 Qershor 1998 dhe rënia e Dëshmorit të fundit me 16 Qershor 1999, dhe në mes tyre 76 Dëshmor tjerë të rënë për lirinë e Kosovës dhe trojeve Shqiptare, ishte dhuratë nga zoti që na i fali këta trima, ua dhuroj pavdekësinë dhe me ndihmën e zotit Malisheva të njëjtën ditë me 16 Qershor 1999, ishte përfundimisht e lirë.

Qëllimi i luftës sonë, ishte liria dhe zhvillimi i vendit. Kështu, me të përfunduar lufta, qytetarët tanë, në vitin 1999 formuan Komunën e Malishevës, për herë të tretë në historinë e saj dhe për të mos u shpërbërë më kurrë.

Filluam ndërtimin, filluam zhvillimin dhe sot Komuna e Malishevës, është rindërtuar në tërësi, me një infrastrukturë rrugore, me shkolla të reja, dhe sot nga një gjysmë shkollë e mesme, kemi tri shkolla të mesme, një gjimnaz dhe dy shkolla profesionale, madje shumë moderne me të cilat me të drejtë mburremi.

Pa ndërpre në këto 16 vite, kemi punuar në përmirësimin e jetës së qytetarëve tanë.

Zonja dhe zotrinj,

Malisheva në tërë historinë e saj, përveç kontributit në çlirimin e vendit, ka dhënë edhe shumë kuadro, si doktor shkencash, mjek, Inxhinier të profileve të ndryshme, ushtarak të nivelit më të lartë, njerëz të shkencës dhe kulturës, i dha zërin më të mirë të këngës “Bilbilin e Kosovës”, Nexhmije Pagarushën, politikan të shquar, njerëz të pushkës dhe penës, duke e bërë Malishevën të mburret me kontributin e vet dhënë Kosovës dhe Shqiptarisë.

Në nderuar të pranishëm,

Në këtë ditë festive, nuk mund të mos i përmendim dhe t’ju falënderohemi edhe mërgimtarëve tanë, të cilët, përveç emrit të mirë për veten e tyre, i dhanë emër të mirë edhe Malishevës, kontribuan për vendin.

Me lejoni që edhe një herë të shprehim respektin dhe përkuljen për të gjithë ata që kontribuan, për lirinë e Malishevës, Kosovës dhe trojeve shqiptare.

Të nderuar qytetarë të Komunës së Malishevës, në emër të Komunës së Malishevës dhe në emrin tim personal, Ju uroj Ditën e Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.

Respekt dhe mirënjohje për të gjithë ata që kanë kontribuar për Malishevën.

Të gjithë dëshmorëve të Kombit, Lavdi.

Kryetari dhe komisioni i aksionarëve takohen me përfaqësuesit e AKP-së

Malishevë, 17 qershor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe Komisioni Komunal i Aksionarëve, sot janë takuar me përfaqësuesit e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), me qëllim të marrjes së informacioneve rreth stacionit të autobusëve në Malishevë, ndërmarrje e cila, me vendim të Kuvendit të Komunës, për fillimin e procedurave për kalimin e stacionit të autobusëve në Malishevë, në pronë publike komunale.

Kryetari Begaj, tha se “është me interes që stacioni i autobusëve, të jetë pjesë e komunës dhe mua më intereson rruga e marrjes nën menaxhim të kësaj ndërmarrje dhe që kjo ndërmarrje të punoj ashtu siç duhet dhe të mos punoj në mënyrë të egër”.

Petrit Ibraj, drejtor regional në AKP, tha se “sipas ligjit stacionet e autobusëve, janë ndërmarrje publike nën menaxhimin e komunave, por në disa raste për shkak të obligimeve, disa nga komunat kanë heziturar të kryejnë këto procedura të marrjes në menaxhimin e tyre”.

Ndërsa, sipas Nexhat Elshanit, menaxher i zyrës së AKP-së në Prizren, “ stacioni në Malishevë, nuk ka shumë obligime, përjashtuar dy konteste pronësore”.

Komisioni komunal i aksionarëve dhe kryetari Begaj, biseduan për procedurat e marrjes nën menaxhim të kësaj ndërmarrje apo shoqëri aksionare, për çka zyrtarët e AKP-së, thanë se nuk ka pengesa rreth kësaj çështje.

Brenda dy viteve, pritet të hapet një fabrikë për përpunimin e gomave

Malishevë, 19 qershor

Komuna e Malishevës, përkatësisht kryetari i Komunës, z.Ragip Begaj dhe kompania “Hydgen Lysis Kosovo”L.L.C., përkatësisht drejtori ekzekutiv i saj, z.Nektarios Kazantzis, kanë nënshkruar kontratën për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, me qëllim të investimit në fushën e prodhimit të gomave, e që sipas operatorit fitues, do të bëjë përpunimin e gomave.



Dhënia në shfrytëzim e pronës komunale, me qëllim të investimit në prodhimtari, paraprakisht është miratuar nga Kuvendi i Komunës së Malishevës dhe i ka kaluar të gjitha procedurat e parapara për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.

Bazuar në kontratën e nënshkruar, “Hydgen Lysis Kosovo”, obligohet që brenda afatit prej 24 muajve të përfundoj investimet dhe përgatitjet për fillimin e punës.

Kjo kompani, fituese e konkursit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, me qëllim të investimit, pritet që të punësoj pesëdhjetë persona, dhe do të bëj përpunimin e gomave të vjetruara, përkatësisht grirjen e gomave, me çka, pritet të hapen vende të reja pune dhe të bëhet pastrimi i ambientit me largimin e gomave.

Në Panorc, u mbajt debat për ndikimin në ambient të ujëmbledhësit

Malishevë, 19 qershor



Organizuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor (MMPH), në bashkëpunim me Komunën e Malishevës, sot në fshatin Panorc, është mbajtur një debat me qytetar, lidhur me raportin e vlerësimit të ndikimit në ambient, nga ndërtimi i akumulacionit të ujit, në këtë fshat.

Në këtë debat, morën pjesë Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, zyrtari i MMPH, z.Shukri Shabani dhe hartues i raportit, z.Elez Krasniqi, ky i i fundit edhe e ka bërë prezantimin e raportit të vlerësimit, të cilin ja ka dërguar ministrisë, ndërsa nga banorët i kanë marrë opinionet lidhur me raportin dhe ndikimin e akumulacionit në mjedis.

Kryetari Begaj, me këtë rast tha se “komuna është vepruar në bazë të ligjit dhe në kuadër të kësaj, duhet të behët edhe vlerësimi i ndikimit të një projekti në ambient dhe në rrethin ku

realizohet projekti”. Ndërsa sipas hartuesit të raportit, z.Elez Krasniqi, ky akumulacion nuk ka ndikime negative dhe nuk e dëmton as botën bimore, ndërsa u dhanë rekomandime, që punëkryesi të bëjë ndërtimin e pendës, në përpikëri me projektin e hartuar.

Më pas sipas qytetarëve, ndërtim i akumulacionit, është i mirëseardhur, për shkak të sigurimit edhe të ujit për pije, por edhe për zhvillimit të turizmit.

U mbajt punëtori për planifikim buxhetor në Malishevë

Malishevë, 22 qershor



Organizuar nga OSBE misioni në Kosovë, sot në Malishevë, është mbajtur një punëtori për përgatitjet e buxhetit të Komunës së Malishevës. Në këtë punëtori morën pjesë zyrtarët përgjegjës të qeverisë komunale, përfaqësues të Kuvendit të Komunës, udhëheqës të komiteteve, si dhe përfaqësues nga shoqëria civile lokale në Malishevë dhe KDI, ku të pranishmit dhanë mendimet e tyre

lidhur me hartimin e buxhetit komunal, 2016-2018.

Fillimisht zyrtari i OSBE-së, z.Yusuke Hara, pasi e hapi punëtorinë, foli për qëllimin e kësaj punëtorie dhe objektivat e saj, ndërsa kryesuesi i KK të Malishevës, z.Aziz Thaçi, e cilësoi si punëtori e qëlluar, pasi kjo bëhet pikërisht në kohën edhe kur është duke u hartuar buxheti komunal për vitin e ardhshëm.

Më pas, drejtori për ekonomi, buxhet dhe financa, në Komunën e Malishevës, z.Vesel Krasniqi, e sqaroi procesin e hartimit të buxhetit, i cili fillon që nga muaji maj dhe përfundon me 30 shtator, kur edhe duhet miratimi përfundimtar. Sipas drejtorit Krasniqi, “gjatë këtij procesi të hartimit të buxhetit, mbahen edhe debat publike me qytetar dhe grupet e interesit, në mënyrë që në hartimin e prioritetëve për investime kapitale të merren parasysh kërkesat e komunitetit, përkatësisht ky planifikim të bëhet duke u bazuar në nevojat e vendbanimeve të Malishevës”. Më pas drejtori Krasniqi, paraqiti edhe kategoritë buxhetore, si dhe dha vërejtjet e tij, lidhur me kufijtë buxhetor të caktuar nga ana e ministrisë, përkatësisht për të hyrat vetanake, ku nga mbi 755 mijë euro, sa ishin këtë vit, Komunës së Malishevës, i është caktuar një kufi prej 1.1 milion euro për vitin 2016, gjë që është vështirë të realizohet dhe pikërisht

për këtë çështje, edhe KK i Malishevës, në diskutimin e qarkores së parë buxhetore, anëtarët e saj, kanë kërkuar zvogëlimin e kësaj shume të paracaktuar.

Më pas, përfaqësuesi i KDI-së, z.Arben Hoxha, që monitoron Asamblenë Komunale, prezantoi prioritetet e kryetarëve të fshatrave të Malishevës, të nxjerra pas një takimi që KDI, kishte mbajtur me ta.

Pas këtyre prezantimeve, pjesëmarrësit e kësaj punëtorie, paraqiten pikëpamjet e tyre, lidhur me hartimin dhe planifikimin buxhetor, për vitet 2016-2018, si dhe nevojën për mbajtjen e debateve me qytetarët, e që në fakt, takimet me përfaqësues të fshatrave, debatet publike që janë të obligueshme me ligj, sipas drejtorit Krasniqi, prioritetet dhe nevojat e vendbanimeve i marrin edhe nga takimet me banorët, të cilat i mbajnë rregullisht në secilin vendbanim.

Fillojnë përgatitjet për fushatën e korrje shirjeve

Malishevë, 22 qershor

Si çdo të hënë edhe sot Këshilli i Drejtorëve, i drejtuar nga Kryetari i Komunës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur mbledhjen e rregullt të qeverisë komunale, ku janë trajtuar një varg çështjesh, që lidhen me punët dhe aktivitetet e përditshme të qeverisë komunale. Gjatë kësaj mbledhjeje kanë raportuar të gjithë drejtorët e drejtorive për aktivitetet e javës së kaluar dhe javës në vazhdim.

Drejtori për Bujqësi z.Hajrullah Mazreku, tha se drejtoria që ai drejton, qysh tani ka filluar përgatitjet për fushatën e korrje shirjeve. “Qysh tani kemi filluar përgatitjet tona dhe do të thërrasim të gjithë auto-kombajnerët nga komuna, për të biseduar me ta për të gjitha detajet e organizimit sa më të mirë të kësaj fushate”, tha drejtori i cili, bëri të ditur, se këtë vit do të ketë mbikëqyrje të rreptë dhe nuk do lejohet që kombajnat të korrin grurin para kohe, pa u pjekur mirë.

Ndrësa drejtoir i urbanizimit, z.Skender Rrahmanaj bëri të ditur se kjo drejtori është në realizimin e shumë projekteve. ”Po vazhdojnë punimet në shkollën e Bubavecit, jemi duke punuar edhe në rrugën Dragobil, po ashtu edhe në projektin e mirëmbajtjeve të rrugëve, jemi duke punuar në segmentin Kërvasari, Panorç, Pagarushë, Gurishtë, Marali, Dragobil dhe në Banjë, kemi përgatitur edhe shumë paramana”.

Sa i përket situatës epidemiologjike me EHKK, drejtori për shëndetësi z.Hajdin Berisha, tha se “gjendja është shumë e qetë, krahasuar me vitin e kaluar, dhe se deri më sot, nuk ka asnjë të infektuar me virusin e EHKK”.

Ndërsa drejtori për Arsim dhe Edukim, z.Blerim Thaçi ka bërë të ditur se, “sot është dita e fundit e procesit mësimor për vitin 2014/2015, në shumicën e shkollave sot përfundon procesi mësimor, përjashtim të atyre shkollave që do të zëvendësojnë orët e humbura”. Drejtori Thaçi, bëri të ditur se testi i maturës, pjesa e dytë ka përfunduar, dhe ka shkuar mirë pa ndonjë vërejtje”.

Dhe krejt në fund, drejtoresha për Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, znj. Blerta Krasniqi, raportoi për përfundimin e aktiviteteve të 16 Qershorit, ku me këtë rast ka falënderuar të gjithë ata që kanë ndihmuar në realizimin e këtij manifestimi, si dhe qytetarët për pjesëmarrje masive, në këto aktivitete.

Begaj mbajti takimin e parë publik me qytetarë për vitin 2015

Malishevë, 25 qershor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Ragip Begaj, sot ka mbajtur takimin e parë publik me qytetarë. Kryetari Begaj, i ka informuar të pranishmit lidhur me aktivitetet e Komunës së Malishevës, gjatë vitit 2015, projektet e realizuara në gjashtë mujorin e parë të vitit, si dhe me projektet të cilat janë në vazhdim e sipër apo në proces të realizimit.

“E di që nevojat janë të mëdha dhe ne po mundohemi të bëjmë më të mirën e mundshme. Premtoj se do të vazhdojmë të jemi transparent në raport me qytetarët, për punën tonë dhe për investimet që bëjmë. Mundësitë buxhetore janë të kufizuara dhe rrjedhimisht nuk mundemi ti plotësojmë të gjitha nevojat që kemi”, tha mes tjerash kryetari Begaj në fjalën e tij.

Më pas, kryetari Begaj, i prezantoi të gjitha projektet të cilat janë realizuar gjatë këtij viti, apo janë në realizim e sipër, si: mirëmbajtja e rrugëve lokale, ndërtimi i fushave të sportit në Drenoc, Gurbardh, Bellanicë, Tërpezë e ulët, pastaj punim të kanalizimeve, në Stapanicë, Drenoc, Lubizhdë, Pagarushë, si dhe mirëmbajtje të kanalizimeve në disa vendbanime. Trotuare në Astrazup, Turjakë, Bubël-Damanek, Carrallukë-Tërpezë, Bubavec, etj... Investime në bujqësi, përkatësisht 18 serra. Ndërtim të rrugëve lokale në Burim, Shkarashnik, Drenoc, Marali dhe Berishë, ndërsa në proces janë rrugët në Dragobil, Qupevë, Turjakë-Bubël, Kërvasari, Pagarushë, Carrallukë, Llazicë, Marali-Gajrfak, Malishevë, Banjë, Guncat, Mirushë dhe Mirushë-Gurbardh. Renovime të objekteve shkollore dhe infrastrukturës shkollore përcjellëse, në Dragobil, Burim, Pagarushë, Malishevë, Lladroc, Astrazup. Ndërtim të shkollave të reja, ujësjellës nëpër fshatra, furnizim me material ndërtimor për raste sociale dhe projekte tjera. Të gjitha, këto kryetari Begaj i paraqiti edhe me shuma, që të gjitha në total kapin një shumë prej mbi 2 milion euro.

“ndoshta jo të gjitha këto projekte mund të përfundojnë sipas planifikimit, pasi kufizimet buxhetore, na pengojnë në realizimin e tërësishëm, por shumica dërmuese do të përfundojnë, mirëpo në këtë rast kërkoj nga ana juaj si qytetar, që ti përcillni realizimin e këtyre projekteve, në mënyrë që mos kryhen punimet shkel e shko dhe ndihma e juaj, na ndihmon edhe neve në këtë drejtim, pasi në disa raste punimet nuk kryhen me cilësinë e dëshiruar”, tha Begaj, dhe ju dha fjalën të pranishmëve, për debat.

Qytetarët dhe përfaqësuesit e fshatrave të cilët morën fjalën, kanë prezantuar nevojat dhe kërkesat e tyre, sikur edhe kanë dhënë vërejtjet e tyre, sidomos në cilësinë e disa projekteve të realizuara, e ku kanë dominuar problemet në ndërtimin e kanalizimeve, pasi në disa vendbanime, pavarësisht investimeve të mëhershme dhe tani, kanalizimet nuk janë funksionale.

Po ashtu të pranishmit i kanë bërë edhe pyetje kryetarit për çështje të caktuara, dhe për të gjitha pyetjet, vërejtjet dhe sugjerimet, është përgjigjur kryetari Begaj.

KKSB: Malisheva e qetë dhe stabile

Malishevë, 25 qershor



Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), mbajti sot takimin e tretë të punës, ku u shqyrtuan një varg çështjes me rëndësi për punën e këtij këshilli, dhe për sigurinë e përgjithshme në Komunën e Malishevës, ku u vlerësua se situata e sigurisë së përgjithshme, është e qetë dhe stabile, dhe pa indikacione për prishjen e sigurisë së përgjithshme.

Kryetari Begaj, në hapje të takimit tha se “besoj që Malisheva të mbajë prapë, epitelin e komunës më të qetë në vend, dhe jam shumë i kënaqur me këtë fakt, për kundër asaj që kemi shumë brenga e probleme tjera qoftë në papunësi, varfëri, strehim, situatë që është brengosëse për të gjithë ne, sidoqoftë prapë është kënaqësi për ne që jemi komunë e qetë dhe nuk kemi probleme të mëdha”.

Po ashtu në këtë takim u diskutuan edhe çështje tjera me rëndësi për sigurinë e përgjithshme në komunën e Malishevës si çështja e projektit të videokamerave në qytet, e cila pritet të realizohet, pastaj fushata sensibilizuese e Policisë së Kosovës, “Festo me zemër, Jo me armë”. Diskutim tjetër ishte edhe siguria në pishina, pastaj gjendja aktuale në komunikacion dhe problematika e parkingut, ku te kjo pikë u pa e nevojshme që rrugët të jenë të lira, ngase po krijon vështirësi në komunikacion, dhe si zakonisht u diskutua edhe për problematikën qenve endacak.

Gjatë kësaj mbledhje për vlerësimin e situatës së sigurisë publike në Komunën e Malishevës, e ka bërë edhe komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiteni Halil Morina, i cili tha se “situata e sigurisë vlerësohet e qetë dhe stabile, dhe pa tendencë të prishjes së kësaj situatë, pasi nuk ka pasur raste që do ta prishte sigurinë në këtë gjashtë mujori të vitit 2015. “Kur jemi në këtë gjashtëmujor, te rastet e krimeve kemi zbritje 45 për qind të rasteve, ndërsa shqetësuese është rritja e numrit të aksidenteve, , ku kemi një rritje prej dhjetë për qind të dëmeve materiale” tha kapiteni Morina.

Qeveria komunale, majtin mbledhjen e rregullt të së hënës

Malishevë, 29 qershor

Qeveria komunale në Malishevë, drejtuar nga Kryetari i Komunës z.Ragip Begaj, si çdo të hënë, ka mbajtur sot takimin e rregullt, ku janë diskutuar një varg çështjesh, në veçanti përgatitjet për korrje-shirjet, pastaj përgatitjet për vitin e ardhshëm shkollor dhe çështje me rëndësi për komunën dhe qeverinë komunale.

Në këtë mbledhje u bë e ditur se drejtorja për bujqësi, i ka bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e sezonit më me rëndësi, asaj të korrje-shirjeve të grurit, ku sipas drejtorit të drejtorisë, Hajrullah Mazreku, është formuar shtabi komunal për përcjelljen e korrjeve, si dhe bëri të ditur se janë në kontakt me 36 auto kombajnerët lokal, të cilët do të jenë të përfshirë në korrjet e këtij viti.

Ndërsa drejtori i arsimit, Blerim Thaçi, tha se drejtorja që ai drejton, është fazën e përgatitjeve për vitin shkollor 2015-2016, ku sipas tij, përveç pritjes për përfundimin e disa objekteve shkollore të reja, “këtë vit do të ketë edhe rritje të numrit të nxënësve, të cilët regjistrohen dhe kjo rritje pritët të jetë për rreth dyqind nxënës”.

Sa i përket situatës epidemiologjike, me EHKK, drejtori komunal për shëndetësi, Hajdin Berisha, ka bërë të ditur, se “kjo situatë, është në kontroll dhe deri më sot nuk kemi raste të infektimit me EHKK”.

Kryetari Begaj, ndau mirënjohje për mërgimtarin Nuhi Mazreku

Malishevë, 29 qershor



diasporë.

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot z.Nuhi Mazreku, mërgimtar nga Malisheva, që jeton dhe punon në Halmstad të Suedisë, ndërsa njihet edhe si themelues i shkollës shqipe në diasporë, përkatësisht në Suedi. Për këtë qëllim, kryetari Begaj, ka ndarë mirënjohje për z.Mazreku, për kontributin e tij në shkollën shqipe në

“Për kontributin që ju keni dhënë në shkollën shqipe në Suedi, kam vendosur të ndaj këtë mirënjohje në shenjë respekti, falënderimi dhe mirënjohjeje për punën tuaj të palodhshme dhe humane, që jeni duke bërë. Me këtë vepër tuajën të madhe, ju keni nderuar veten tuaj dhe keni nderuar Malishevën”, tha kryetari Begaj, me rastin e dhënies së mirënjohjes për Nuhi Mazrekun.

“Në jetën time, kam marrë shumë mirënjohje dhe dekorata, por kjo është shumë me rëndësi për mua dhe shumë e veçantë, pasi më nderon vendi im dhe nuk ka asgjë më mirë se kur vendi yt të vlerëson apo të nderon si në këtë rast”, tha z.Nuhi Mazreku, me rastin e pranimit të mirënjohjes.

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, me rastin e Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, ka ndarë mirënjohje për z.Nuhi Mazreku, për kontributin e dhënë në shkollën shqipe në diasporë, por për shkaqe objektive, z.Mazreku, nuk ishte prezent më 16 Qershor në Malishevë.

Nuhi Mazreku, mësues nga Malishevë dhe një ish i përndjekur politik, kishte emigruar në Suedi, ndërsa pas shumë përpjekjeve, kishte arritur që të organizoj mësimin shqip për fëmijët e bashkatdhetarëve tanë që jetonin në Suedi. Mësimin e kishte filluar tridhjetë vite më parë, në Halmsatd të Suedisë, me vetëm dy nxënës, por përkushtimi dhe dëshira e tij për mësimin dhe për nxënësit, ka arritur që sot kjo shkollë shqipe, ti ketë mbi 270 nxënës.